



REPUBLIKA SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
Keshilli I Basenit Ujembledhes Mat

V E N D I M

Nr.02/4 Date 17.06. 2010

Per

Ndryshim te Vendimit nr.05 date 30.05.2007 “El Er Energy” shpk Gjet Stojani, Perroi Sheshit- Burrel, dhe miratim te ri me te dhenat e ndryshuara.

Ne mbeshtetje te nenit 8 pika 1, neni 14, neni 18 te ligjit Nr.8093 date 21.03.1996”Per rezervat Ujore”, neneve 8, pika 4, e 27, te ligjit nr. 9663, date 18.12.2006, “Për koncesionet”, Vendimit K.M. Nr. 27 date 19.01.2007, “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve, Kreu XI, pika 9, me propozim te A.U.B.Mat per paisjen me leje koncensionare shoqerise “El Er Energy” shpk Gjet Stojani, sipas kerkeses date 15.05.2010, **Keshilli i Basenit Mat, shqyrtoi kerkesen e tij per mbajtjen ne fuqi te vendimit nr. 05 date 30.05.2007 Perroi Sheshit- Burrel, me prurje te ndryshuar nga 0,35 m3/sek ne 0,144 m3/sek si dhe ndryshimin e kuotes se vepres se marrjes nga 362m ne 396/392m, mbas diskutimeve K.B.U.Mat,**

V E N D O S I:

1-Ndryshim te vendimit nr. 05 date 30.05.2007 per miratimin ne parim te kerkeses se “El Er Energy” shpk Gjet Stojani per Leje Kocesionare Perdorim Rezerva Ujore per Energji Elektrike sipas studimit te paraqitur nga subjekti “El Er Energy” shpk Gjet Stojani.

2.Miratim ne parim te kerkeses per perdorim uji per energji elektrike me te dhena te ndryshuara:

-Prurja mesatare : $Q=0,144$ m3/sek,

-Kuota e vepres se marrjes 396/392m.

3- “El Er Energy” shpk Gjet Stojani duhet te lidhe marrveshjen e perdorimit te ujit me K.B.U.Mat sipas percaktimeve qe parashikohen ne ligj pa ndryshimin e regjimit te vaditjes, furnizimit me uje te popullates etjere per ruajtjen e flores dhe faunes .

4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B. MAT
Pashk NDOCI



KRYETARI I K.B.U. MAT
Pal DAJCI

